



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/05
Datë: 06.03.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. të nenit 93 paragrafi (4) dhe të nenit 119 paragrafi 9. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 5 paragrafit 1 lidhur me nenin 43 të Ligjit 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, ndryshuar me ligjet 04/L-111 dhe 05/L-009, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 6 mars, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Emërohet Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve i ndërmarrjes publike qendrore "Telekomi i Kosovës" Sh. A., me këtë përbërje:
 - 1.1. z. Genc Rraci, kryesues dhe drejtor
 - 1.2. z. Naim Maloku, drejtor
 - 1.3. znj. Luljeta Elezaj, drejtore
 - 1.4. z. Teki Shala, drejtor
2. Mandati i Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve mbaron:
 - 2.1. Ditën që emërohet Bordi i Drejtorëve me mandat të plotë; ose
 - 2.2. Ditën që bëhen gjashtë muaj nga emërimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Për arsyet e cekura në memorandumun shpjegues të Ministres së Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike, Qeveria vendosi si në dispozitiv.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë
- Ndërmarrjes "Telekomi i Kosovës" Sh.A.



Republika e Kosovës
Republika Kosova / Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë, Punësimit, Tregtisë, Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Investimeve Strategjike
Ministarstvo Ekonomije, Zapošljavanja, Trgovine, Industrije, Preduzetništva i Strateških Ulaganja
Ministry of Economy, Employment, Trade, Industry, Entrepreneurship and Strategic Investments

DATË/E:	6.3.2020
PËR/ZA/TO:	Qeverinë e Republikës së Kosovës
NGA/OD/FROM:	Rozeta HAJDARI – Ministre, MEPTINIS
TEMA/ SUBJEKAT/ SUBJECT:	Memorandum shpjegues për propozim-vendimin për emërimin e bordit të përkohshëm të drejtorëve të ndërmarrjes publike qendrore “Telekomi i Kosovës” Sh.A.

I nderuar Kryeministër Kurti,
të nderuar zëvendëskryeministra Hoti dhe Abazi,
të nderuar ministra:

Si ministre përgjegjëse, i propozoj Qeverisë ta emërojë një bord të përkohshëm të drejtorëve të ndërmarrjes “Telekomi i Kosovës” Sh.A. Këtë propozim e jap duke u mbështetur në Kushtetutë dhe në Ligjin për ndërmarrjet publike.¹

Për emërim propozoj këtë përbërje të bordit të përkohshëm:

- z. Genc Rraci, kryesues dhe drejtor;
- z. Naim Maloku, drejtor;
- znj. Luljeta Elezi, drejtore; dhe
- z. Teki Shala, drejtor.

Kur shkarkohet bordi i drejtorëve, neni 43 i Ligjit për ndërmarrjet publike detyron Qeverinë që sa më shpejt të emërojë një bord të përkohshëm të drejtorëve. Qeveria emëron katër drejtorë të përkohshëm, dhe ata mund të caktojnë kryeshefin e ndërmarrjes, i cili shërben si drejtori i pestë në bord. Ndonëse nuk lypset konkurs, për aq sa është e mundshme, duhet emëruar kandidatë që plotësojnë kushtet dhe cilësimet e përcaktuara për drejtorët me mandat të plotë.²

1 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 119.9; Ligji 03/L-087 për ndërmarrjet publike, ndryshuar me ligjet 04/L-111 dhe 05/L-009 (LNP), nenet 5.1 dhe 43.

2 Shih LNP, neni 17, para. 1 e 4.

Drejtorët e përkohshëm të propozuar janë ekspertë të sektorit në të cilin vepron ndërmarrja dhe ekspertë të qeverisjes së ndërmarrjeve (përfshi menaxhmentin, financat dhe auditimin), me përvojë të dëshmuar në vende të zhvilluara dhe te ne në Kosovë.

Rozeta HAJDARI

Ministre